



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI



MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË
“UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A,”

Tiranë, Shtator, 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	6
II	HYRJA	6
1.	Objektivat dhe qëllimi	7
2.	Identifikimi i çështjes	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet e auditimit	9
7.	Metoda e auditimit	9
8.	Dokumentimi i auditimit	9
I.I.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	10
2.1.	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	
	<i>a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.</i>	10-12
2.2.	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit	
	<i>a. Investimet në teknologjinë e informacionit.</i>	12-34
	<i>b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit</i>	
2.3	Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit	
	<i>a. Auditimi i sistemeve mbi të dhënat Input / Output</i>	34-41
	<i>b. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.</i>	
IV.	REKOMANDIME	42

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi Emërtimi i Plotë

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
UKSH	Ujësjetllës Kanalizime Shkodër
RSH	Republika e Shqipërisë
BCP	Business Continuity Plan
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
BCC	Business Continuity Center
MNSH	Marrëveshjeve Nivel Shërbimi
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
SSL	Secure Sockets Layer
VPN	Virtual Private Network
LAN	Local area network
IP	Internet Protocol

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A, nga data 18.04.2024 deri më datë 10.07.2024.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Mbështetur në punën në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese. Rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit i sistemeve të Informacionit është i rëndësishëm për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi ka rezultuar se, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk disponon një strategji institucionale si dhe nuk disponon as një strategji mbi teknologjinë e informacionit mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit. Gjithashtu, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

- Nga auditimi u konstatua se UKSH nuk ka marrë masa për përditësimin dhe implementimin e rregullores së brendshme si një dokument mbi të cilin kjo shoqëri bazohet për të kryer funksionet e saj. Me ndryshimet e ndodhura në strukturën e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ku sektori i IT nuk është më në varësi të Drejtorisë Tregtare por ka kaluar në varësi Drejtorisë Administrativo-Ligjore si dhe ristrukturimin e saj kjo rregullore nuk ka ndryshuar. Gjithashtu,

pavarësisht mos përditësimit të kësaj rregulloreje mungojnë dhe përshkrimet e plota të detyrave duke mos përfshirë detyrat për specialistët përkatës të këtij sektori.

- Nga auditimi u konstatua se, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH, të lidhur ndërmjet AK dhe OE “R.A shpk” me kontratën nr. 39 Prot., datë 08.01.2024, mallrat janë dorëzuar 18 ditë me vonesë nga afati i zbatimit të kontratës dhe për pasojë është miratuar një Urdhër i Brendshëm për likuidimin e dëmit për vonesën në vlerën 268,704 lekë. Nga auditimi u konstatua se, nga sektori i financës nuk është bërë likuidimi i kontratës ndonëse nga OE është përcjellë fatura nr. 158/2024, datë 15.01.2024. Gjithashtu, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për mbajtjen e dëmit mbi vonesën ndonëse kanë kaluar afërsisht 6 muaj nga përlogaritja e tij.

Nga auditimi rezulton se Fjalëkalimi në sistemin Billing aktualisht nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij .kriteret e ndërtuara për fjalëkalimet e përdoruesve fundor nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë.

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. - Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

-Nga auditimi u konstatua se UKSH, nuk rezulton të ketë, dokumentim/implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit. UKSH nuk disponon dokumentacione në lidhje me planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të serverit që suportojnë sistemin e Faturimit, Web-Gis. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

-Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e UKSH Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyre attributeve individualisht dhe pa autorizim nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Ujësja Kanalizime Shkodër sh.a të marrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie institucionale ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë së institucionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave.

- Ujësja Kanalizime Shkodër sh.a duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit që ofron dhe të dhënave që institucioni disponon dhe përpunon, të analizojë mundësinë e ndryshimit të strukturës ekzistuese TI me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrë masa për kalim nga nivel Sektori në nivel Drejtorie.

- Ujësja Kanalizime Shkodër sh.a të marrë masa për përditësimin dhe implementimin e rregullores së brendshme si një dokument mbi të cilin kjo shoqëri bazohet për të kryer

funkcionet e saj, duke përfshirë dhe përshkrimet e punës dhe duke i përshtatur ato me detyrat funksionale që punonjësit ushtrojnë.

- UKSH Sh.A, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemin “Billing” ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu, të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit mbi funksionalitetet e sistemit informatikë “Billing

- Strukturat drejtuese në UKSH Sh.A në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat. Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të Ujësjetllësit, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cenimin e të dhënave të sistemeve.

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014. Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2023 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, Investimet në fushën TIK dhe sistemet e teknologjisë së informacionit që Ujësjetllës Kanalizime Shkodër ka në përdorim dhe mbështet aktivitetin e saj. UKSH SH.A nuk ka një strategji dhe një plan menaxhimi të rrishtit. Pa një drejtim të qartë strategjik dhe një qasje proaktive për identifikimin e rreziqeve, UKSH Sh.A është e papërgatitur për të përmirësuar infrastrukturën e saj teknologjike.

Mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera UKSH ShA nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në sisteme. UKSH Sh.A nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve). Mungesa e mekanizmave të vazhdueshëm të monitorimit do të thotë që çdo anomali ose aktivitet i dyshimtë brenda sistemit mund të mbetet i pashqyrtuar, duke rritur gjasat e ekspozimit ndaj kërcënimeve. Investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit janë të pamjaftueshme. Kjo mungesë financiare kufizon aftësinë e UKSH Sh.A për të investuar në teknologjitë e nevojshme, për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e sigurisë, vazhdimësinë e punës.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit 479/1 Prot, datë 18.04.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 18.04.2024 deri në 10.07.2024, në Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a, (më poshtë UKSH), ku periudha e audituar është 01.01.2022 deri në 31.12.2023, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare
3. A.K, anëtare

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.a, është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

II.2 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.479/1 Prot, datë 18.04.2024:

1.Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.

2.Auditimi i zhvillimit dhe blerjes për teknologjinë e informacionit

a. Investimet në teknologjinë e informacionit.

b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit

3.Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit

a.. Auditimi i sistemeve mbi të dhënat Input / Output

b. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

4. Të tjera

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Strukturat drejtuese kanë për detyrë hartimin e rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së shoqërisë, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë t, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke parashikuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre. Shoqëria brenda kuadrit përkatës të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Në zbatim të dispozitave ligjore, U.K. Shkodër SHA. merr masa për: -Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të Shoqërisë. -Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë. - Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri. -Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën Kolektive të Punës.

Në zbatim të dispozitave ligjore, U.K. Shkodër SHA. merr masa për:

- Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të Shoqërisë.
- Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
- Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën Kolektive të Punës

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.a,, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2023, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen

me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 479/1 Prot, datë 18.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon UKSH. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë Raport Përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji Nr. 162 Date 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Kodi i Furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Ligji nr.990, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- Statuti i Shoqërisë;
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.",
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore".
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- VKMnr.710,datë 21.08.2013"Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar.
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 "për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit", i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj

II.7 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në UKSH, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime, funksionon në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”

- Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë, krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:
 - Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
 - Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; -Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
 - Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
 - Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre; - Shoqëria duhet të realizojë çdolloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
 - Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçensat sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përshkrimi i rezultateve të auditimit

2.1 Auditimi i Funkcionimit të Qeverisjes TIK

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Statutit të Shoqërisë aksionare “Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a.” miratuar më datë 05.04.2023.

UKSH siguron furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimeve në Qarkun Shkodër. Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka detyrimin të përmbushë një sërë detyrash për të siguruar shërbimin me ujë të pijshëm për popullatën në zonën e saj të shërbimit.

Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a më 19.01.2023 ka lidhur marrëveshje me Bashkitë Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizime (SKP-UK) e cila do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive të cilat janë palë e kësaj marrëveshje, pjesë e të cilës është edhe AKUM. Kjo shoqëri është ngarkuar me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të Bashkive palë me këtë marrëveshje. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a është në masën 10,000,000 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar se, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk disponon një strategji institucionale si dhe nuk disponon as një strategji mbi teknologjinë e informacionit mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit. Gjithashtu, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre. Mungesa e një plani strategjik institucional të lidhur edhe me teknologjinë e informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të cilat mund të mbështesin mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektiveve të institucionit. Për sa më lart, UKSH duhet të kishte marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektiveve institucionale, ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

Me shkresën nr. 3 Prot., datë 10.07.2023 është miratuar Vendimi për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin e aksionarit të ri të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të pagueshme në para. Shoqëria ka emetuar 286,730 copë aksione të reja të zakonshme me vlerë nominale prej 100 lekë secili, me një vlerë totale prej 28,673,000 lekë. Pas zmadhimit kapitali ligjor i shoqërisë është bërë 38,680,000 lekë i përbërë nga 386,800 aksione me vlerë nominale prej 100 lekë secili. Përbërja aksionare dhe pjesëmarrja pas zmadhimit rezulton:


Tabela nr.1

Aksionari	Nr. i aksioneve të zakonshme të zotëruara _Copë	Përqindja e pjesëmarrjes në kapital	Vlera e kapitalit të zotëruar _Lekë	Vlera e kapitalit të paguar _Lekë
MIE	197,270	51.00%	19,727,000	12,600,000
Bashkia Shkodër	140,530	36.33%	14,053,000	0
Bashkia Fushë Arrëz	3,330	0.86%	333,000	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	24,700	6.39%	2,470,000	2,470,000
Bashkia Pukë	8,490	2.19%	849,000	849,000
Bashkia Vau i Dejës	12,480	3.23%	1,248,000	1,248,000
TOTAL	386,800	100.00%	38,680,000	17,500,000

Burimi: UKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi ka rezultuar se në strukturën e miratuar me vendim nr. 05 datë 31.08.2023 me lëndë “Për miratimin e organigramës dhe nivelit të pagave të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës – Kanalizime Shkodër, sh.a për vitin 2023” institucioni ka një numër total prej 500 punonjësish. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka në strukturën e saj të miratuar sektorin e IT të cilët janë në varësi të Drejtorisë Administrativo-Ligjore. Ky sektor është i përbërë nga 1 përgjegjës sektori IT dhe 3 specialistë IT.

Figura nr.1: Struktura e UKSH



Burimi: UKSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, nisur nga objektivat e UKSH nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga sektori i IT për administrimin e sistemeve informatike. Sektori i IT i cili është në varësi të Drejtorisë Administrativo Ligjore nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në UKSH duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e shoqërisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkte nga menaxhimi i lartë.

Trajnimet

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga komunikimet verbale me subjektin deri më tani në Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Mungesa e trajnimeve sipas fushave përkatëse për sektorin e teknologjisë së informacionit bën që për pasojë ata të mos mund të zbatojnë si duhet detyrat e përcaktuara në përkrahjet e punës sipas rregullores dhe statutit të UKSH.

-Nga auditimi u konstatua se, nuk ka propozime konkrete nga niveli menaxherial i UKSH për zhvillimin e trajnimeve si dhe nuk është i dokumentuar procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim, duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret e institucionit, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

UKSH ushtron aktivitetin e tij në zbatim të “Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a” miratuar me nr. 23, datë 13.09.2017.

-Nga auditimi u konstatua se UKSH nuk ka marrë masa për përditësimin dhe implementimin e rregullores së brendshme si një dokument mbi të cilin kjo shoqëri bazohet për të kryer funksionet e saj. Me ndryshimet e ndodhura në strukturën e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ku sektori i IT nuk është më në varësi të Drejtorisë Tregtare por ka kaluar në varësi të Drejtorisë Administrativo-Ligjore si dhe me ristrukturimin e saj kjo rregullore nuk ka ndryshuar. Gjithashtu, pavarësisht mos përditësimit të kësaj rregulloreje mungojnë dhe përkrahjet e plota të detyrave duke mos përfshirë detyrat për specialistët përkatës të këtij sektori. Mungesa e bazës

së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje dhe jo sipas procedurave të përcaktuara, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme. Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në UKSH.

Nga auditimi u konstatua se, Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a nuk disponon regjistër risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit:

a) *Investimet në teknologjinë e informacionit;*

b) *Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.*

Për periudhën objekt auditimi 2022-2023, Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a ka realizuar rreth 10 procedura prokurimi për teknologjinë e informacionit, me vlerë 9,450,000 lekë pa TVSH dhe 11,340,000 lekë me TVSH. Përkatesisht, për vitin 2022 janë realizuar rreth 5 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 3,180,000 lekë pa TVSH. Për vitin 2023, janë realizuar rreth 5 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 6,270,000 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit deri më tani ka marrë në shqyrtim 10 dosje të procedurave të prokurimit publik të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Realizimet për Vitin 2022			
Objekti i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
Materialet kompjuterike	1,553,000.00	1,494,000.00	1,792,800.00
Shërbim i Mirëmbajtjes së Sistemit të Faturimit AL-Billing	873,755.00	400,000.00	480,000.00
Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike	300,000.00	256,000.00	307,200.00

Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022	700,000.00	480,000.00	576,000.00
Shërbim internet	700,000.00	550,000.00	660,000.00
Realizimet për Vitin 2023			
Objekti i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
Blerje materiale kompjuterike	3,483,500.00	3,110,000.00	3,732,000.00
Shërbim internet	318,182.00	300,000.00	360,000.00
Upgrade i programit të faturimit	1,500,000.00	990,000.00	1,188,000.00
Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit	1,500,000.00	1,125,000.00	1,350,000.00
Shërbim internet	760,000.00	745,000.00	894,000.00

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” 2022**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje materiale kompjuterike		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 682, datë 16.05.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. F.T Znj. V.S Z. A.T	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. S.Sh Z. G.M Znj. I.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,530,500 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,494,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 36,500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 03.06.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1192/1, dt. 12/08/2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,792,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 15 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 Operator Ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 09.06.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi

mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqit një ofertë nga Operatori Ekonomik “P.S” me vlerë 1,494,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua. Administratori i UKSH me shkresën nr. 863 Prot., datë 14.06.2022 miratoi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku shpalli fitues OE “P.S”.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

Me shkresën nr. 1301 Prot., datë 26.08.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të materialeve kompjuterike, ku komisioni i përbërë nga A.T, A.B dhe S.Sh kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specififikimet teknike.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikim Raportimit më datë 16.05.2022 ka bërë përlogaritjen e fondit limit me kërkesën e përgjegjësit të sektorit të TI për blerje materiale kompjuterike në vlerën 1,530,500 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 682 Prot., datë 16.05.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 155, datë 16.05.2022 nga Administratori i UKSH. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Blerje materiale kompjuterike” me fond limit 1,530,500 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e shoqërisë. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga F.T, V.S dhe A.T.

- Me shkresën nr. 683 Prot., datë 16.05.2022 është miratuar Urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr. 156, datë 16.05.2022 i përbërë nga S.Sh, kryetare Komisioni, G.M dhe I.M.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 09.06.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqit një ofertë nga Operatori Ekonomik “P.S” me vlerë 1,494,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

- Administratori i Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a ka miratuar raportin përmbledhës nr. 862 Prot., datë 14.06.2022 mbi tenderin me objekt “Blerje materiale kompjuterike” për të cilin u zhvillua tenderi më datë 03.06.2022 ku u paraqit vetëm një ofertë nga OE “P.S”. Raporti përmbledhës nuk është nënshkruar nga G.M anëtar i KVO.

- Formulari i njoftimit të fituesit i miratuar nga Administratori me shkresën nr. 864, datë 14.06.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” pas shpalljes së fituesit ka informuar OE fitues “P.S” se brenda një afati 5 ditor nga publikimi i njoftimit, duhet të paraqesi në Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet edhe në dokumentet e tenderit. Në rast mospajtimi me këtë kërkesë ose nëse nuk dorëzohet sigurimi i kontratës brenda afatit përfundimtar OE duhet të tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës si dhe do të bëhet konfiskimi i sigurimit të ofertës siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

- Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “P.S” kanë nënshkruar kontratën nr. 1192/1, datë 12.08.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” me vlerë 1,494,000 lekë pa TVSH dhe 1,792,800 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 1301 Prot., datë 26.08.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të materialeve kompjuterike, ku komisioni i përbërë nga A.T, A.B dhe S.Sh kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specififikimet teknike.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim i Mirëmbajtjes së Sistemit të Faturimit AL-Billing” 2022**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim i Mirëmbajtjes së Sistemit të Faturimit AL-Billing		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1342, datë 31.08.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 800,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 400,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 400,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 01.09.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1382, dt. 08/09/2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 480,000 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 12 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 01.09.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin ka skualifikuar Operatorin Ekonomik “L.Ç”, për arsye se vlera e ofertës ekonomike ishte më e ulët se 50% e vlerës së fondit limit si dhe ka shpallur në vendin e parë Operatorin Ekonomik “E.S.S” me vlerë 400,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1381 Prot., datë 08.09.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 331, datë 08.09.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga S.A, A.T dhe B.K. Në zbatim të urdhrin për zbatimin e kontratës nuk ka një procesverbal të mbajtur nga grupi i caktuar për marrjen në dorëzim të shërbimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Në datën 12.08.2022 përgjegjësi i sektorit të TI ka bërë kërkesë për Shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të faturimit.

- Sektori i Planifikimit në përbërje me vetëm dy punonjës më datë 30.08.2022 ka bërë përlllogaritjen e fondit limit për objektin Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit të faturimit në vlerën 800,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1342 Prot., datë 31.08.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 319, datë 31.08.2022 nga Administratori i UKSH sh.a. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit të faturimit”.

- Komisioni me përbërje G.M, V.S dhe A.M më datë 31.08.2022 ka mbajtur një procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

- Komisioni i blerjeve të vogla më datë 01.09.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin nuk jep ofertat e paraqitura për të bërë kualifikimin ose skualifikimin e tyre si dhe për të shpallur më pas një fitues. Në këtë shkresë thuhet se është skualifikuar L.Ç për arsye se vlera e ofertës ekonomike ishte më e ulët se 50% e vlerës së fondit limit.

- Me shkresën nr. 1355 Prot., datë 01.09.2022 titullari i institucionit aprovon vendimin e dhënë nga komisioni i blerjeve të vogla për shpalljen e fituesit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 01.09.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin janë paraqitur pesë oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “E.S.S” me vlerë 400,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “K.” me vlerë 560,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.
3. Operatori Ekonomik “P.A” me vlerë 708,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
4. Operatori Ekonomik “O.S” me vlerë 780,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.
5. Operatori Ekonomik “L.Ç”, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua, vlera e ofertës nga ky operator nuk është pasqyruar në procesverbal.

- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “E.S.S Shpk”. AK nuk ka mbajtur një procesverbal mbi njoftimin e fituesit, siç është e parashikuar në nenin 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit.

- Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “E.S.S Shpk” kanë nënshkruar kontratën nr. 1382 Prot., datë 08.09.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të faturimit Al-Billing” me vlerë 400,000 lekë pa TVSH dhe 480,000 lekë me TVSH.

- Në kontratën e lidhur ndërmjet Operatorit Ekonomik “E.S.S Shpk” dhe Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a janë listuar një sërë detyrash dhe objektivash ku pjesa më e madhe e tyre janë zbatuar brenda afatit të përcaktuar. Përgjegjësi i sektorit IT ka mbajtur procesverbale periodike mbi mbarëvajtjen e sistemit dhe problematikave të hasura gjatë punës por UKSH nga ana tjetër nuk ka marrë asnjë raport mujor nga Operatori Ekonomik siç është përcaktuar edhe në detyrat që duhen përbushur në kontratë.

- Me shkresën nr. 1381 Prot., datë 08.09.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 331, datë 08.09.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga S.A, A.T dhe B.K. Në zbatim të urdhrin për zbatimin e kontratës nuk ka një procesverbal të mbajtur nga grupi i caktuar për marrjen në dorëzim të shërbimit.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga

ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike” 2022.**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 536, datë 21.12.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.T	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.T
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 292,677 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 256,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 36,677 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 22.12.2022		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 8 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 7 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 72, dt. 16/01/2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 307,200 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 7 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Më datë 31.01.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 2, datë 31.01.2023.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Më datë 31.01.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 2, datë 31.01.2023.

Zhvillimi i kontratës:

- Në datën 12.12.2022 përgjegjësi i sektorit të IT ka bërë planifikimin e kërkesës për riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve elektronike.

- Sektori i Planifikimit në përbërje me vetëm dy punonjës më datë 21.12.2022 ka bërë preventivin për procedurën me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike” llogaritur në vlerën 292,667 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 2076 Prot., datë 21.12.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 536, datë 21.12.2022 për procedurën me vlerë të vogël me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje të pajisjeve elektronike” nga Administratori i UKSH sh.a.

- Komisioni me përbërje G.M, V.S dhe A.T më datë 21.12.2022 ka mbajtur një procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.
- Me shkresën nr. 2120 Prot., datë 27.12.2022 është bërë miratimi nga titullari i Autoritetit Kontraktor për procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për shpalljen e operatorit ekonomik “L.S” si operatori ofertues i kualifikuar me ofertën më të ulët.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit. Nga printimi i bërë nga komisioni nga sistemi i APP janë paraqitur shtatë oferta si më poshtë:
 1. Operatori Ekonomik “L.S” me vlerë 180,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 2. Operatori Ekonomik “T” me vlerë 236,200 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.
 3. Operatori Ekonomik “A” me vlerë 250,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 4. Operatori Ekonomik “J.G” me vlerë 250,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 5. Operatori Ekonomik “B.2019” me vlerë 256,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 6. Operatori Ekonomik “X.S” me vlerë 264,500 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 7. Operatori Ekonomik “C” me vlerë 268,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
 8. Operatori Ekonomik “R.2000” me vlerë 268,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.
- Më datë 28.12.2022 është mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori i radhës pasi operatori ekonomik fitues “L.S” ka bërë në sistemin elektronik të APP kërkesë për tërheqje nga procedura.
- Më datë 30.12.2022 është mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori i radhës pasi operatori ekonomik tjetër fitues “T” nuk është paraqitur për të dorëzuar dokumentacionin e plotë të kërkuar nga AK.
- Më datë 09.01.2023 është mbajtur sërish procesverbal për kalimin tek operatori i radhës pasi operatori ekonomik fitues “A” në sistemin elektronik të APP ka bërë kërkesë për tërheqje nga procedura për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e procedurës në afatet e kërkuara nga AK në ftesën për ofertë.
- Më datë 11.01.2023 është mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori i radhës pasi edhe operatori ekonomik fitues “J.G” në sistemin elektronik të APP ka bërë kërkesë për tërheqje nga procedura për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e procedurës në afatet e kërkuara nga AK në ftesën për ofertë.
- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “B.2019 shpk”. AK nuk ka mbajtur një procesverbal mbi njoftimin e fituesit, siç është e parashikuar në nenin 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit. Pjesë e dosjes është vetëm një shkresë e gjeneruar nga sistemi i APP-së mbi njoftimin e fituesit.

- Me shkresën nr. 58 Prot., datë 12.01.2023 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 20, datë 12.01.2023 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga S.A, B.D dhe A.T.

- Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “B.2019 shpk” kanë nënshkruar kontratën nr. 72 Prot., datë 16.01.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike” me vlerë 256,000 lekë pa TVSH dhe 307,200 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 72/1 Prot., datë 20.01.2023 është bërë Amendament për zgjatjen e afatit të kontratës me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike” midis Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. dhe operatorit ekonomik “B.2019 shpk”, ku afati i shtyrjes së kontratës është bërë deri më datë 31.01.2023. Arsyeja e zgjatjes së afatit është bërë për arsye të pamundësisë së kryerjes së të gjitha shërbimeve brenda afatit 7 (shtatë) ditor të përcaktuar në kontratën themelore me nr. 72 Prot., datë 16.01.2023.

- Më datë 31.01.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 2, datë 31.01.2023.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 369, datë 27.09.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.M Znj. V.S Znj. A.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 484,750 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 480,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 4,750 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 29.09.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1778, dt. 02/11/2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 576,000 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 12 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e

punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Më datë 30.09.2022 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022”, me fond limit 484,750 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë prokurimi ka pasur vetëm një Operator Ekonomik pjesëmarrës Operatori Ekonomik “I. shpk”, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 1777 Prot., datë 02.11.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 457, datë 02.11.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga A.T, B.D dhe E.C. Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është pjesë e dosjes së prokurimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Në datën 19.09.2022 përgjegjësi i sektorit të TI dhe përgjegjësjë e planifikimit kanë bërë kërkesë për shërbim dhe mirëmbajtje GIS për vitin 2022.

- Sektori i Planifikimit në përbërje me vetëm dy punonjës më datë 27.09.2022 ka bërë preventivin për procedurën me objekt “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022” llogaritur në vlerën 484,750 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1490 Prot., datë 27.09.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 369, datë 27.09.2022 për procedurën me vlerë të vogël me objekt “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022” nga Administratori i UKSH sh.a.

- Komisioni me përbërje G.M, V.S dhe A.M më datë 27.09.2022 ka mbajtur një procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

- Më datë 30.09.2022 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022”, me fond limit 484,750 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë prokurimi ka pasur vetëm një Operator Ekonomik pjesëmarrës:

1. Operatori Ekonomik “I. shpk”, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “I. shpk”. AK nuk ka mbajtur një procesverbal mbi njoftimin e fituesit, siç është e parashikuar në nenin 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit. Pjesë e dosjes është vetëm një shkresë e gjeneruar nga sistemi i APP-së mbi njoftimin e fituesit.

- Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “I. shpk” kanë nënshkruar kontratën nr. 1778 Prot., datë 02.11.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022” me vlerë 480,000 lekë pa TVSH dhe 576,000 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 1777 Prot., datë 02.11.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 457, datë 02.11.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga A.T, B.D dhe E.C. Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është pjesë e dosjes së prokurimit.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” 2022**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim interneti		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 135, datë 05.05.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. G.M Znj. V.S Znj. B.K	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.M Znj. V.S Znj. B.K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 628,200 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 550,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 78,200 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 06.05.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 672, dt. 13/05/2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 660,000 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 12 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

- **Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- **Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Më datë 09.05.2022 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbim interneti”, me fond limit 628,200 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë prokurimi ka pasur tre Operatorë Ekonomik pjesëmarrës, si më poshtë:

- Operatori Ekonomik “I.C”, me vlerë 450,000 lekë pa TVSH, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

- Operatori Ekonomik “I.B.C-T”, me vlerë 550,000 lekë pa TVSH, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

- Operatori Ekonomik “A.”, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 638 Prot., datë 10.05.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 140, datë 10.05.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga A.T, B.D dhe S.Sh. Procesverbali i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore nuk janë pjesë e dosjes së prokurimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Në datën 26.04.2022 përgjegjësi i sektorit të TI dhe përgjegjësjë e planifikimit kanë bërë kërkesë për shërbim interneti për vitin 2022.

- Sektori i Planifikimit më datë 05.05.2022 ka bërë preventivin për procedurën me vlerë të vogël me objekt “Shërbim interneti” llogaritur në vlerën 628,200 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 601 Prot., datë 05.05.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 135, datë 05.05.2022 për procedurën me vlerë të vogël me objekt “Shërbim interneti” nga Administratori i UKSH sh.a.

- Komisioni me përbërje G.M, V.S dhe B.K më datë 05.05.2022 ka mbajtur një procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

- Më datë 09.05.2022 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbim interneti”, me fond limit 628,200 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë prokurimi ka pasur tre Operatorë Ekonomik pjesëmarrës, si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.C”, me vlerë 450,000 lekë pa TVSH, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

2. Operatori Ekonomik “I.B.C-T”, me vlerë 550,000 lekë pa TVSH, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

3. Operatori Ekonomik “A.”, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.

- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “I.B.C-T”. AK nuk ka mbajtur një procesverbal mbi njoftimin e fituesit, siç është e parashikuar në nenin 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit. Pjesë e dosjes është vetëm një shkresë e gjeneruar nga sistemi i APP-së mbi njoftimin e fituesit.

- Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “I.B.C-T” kanë nënshkruar kontratën nr. 672 Prot., datë 13.05.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” me vlerë 550,000 lekë pa TVSH dhe 660,000 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 638 Prot., datë 10.05.2022 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 140, datë 10.05.2022 për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga A.T, B.D dhe S.Sh. Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është pjesë e dosjes së prokurimit.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” 2023

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje materiale kompjuterike		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 143, datë 06.10.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	Z. F.T Z. A.T Z. K.A	Z. L.P Znj. S.Sh Z. B.B

5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,477,567 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 3,110,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 367,567 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 23.10.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP – ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 39, dt. 08/01/2024	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 3,732,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 15 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 27.10.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën dy oferta si më poshtë:

1.Operatori Ekonomik “R.A” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

2.Operatori Ekonomik “S.C” me vlerë 3,449,600 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

Me shkresën nr. 2478 Prot., datë 28.12.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “R.A” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Më datë 05.02.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të materialeve kompjuterike, ku komisioni i përbërë nga S.Sh, B.B dhe B.T kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Mallrat janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 158/2024, datë 15.01.2024 duke deklaruar përmbushjen e kushteve dhe specifikimeve të kontratës. Mallrat janë dorëzuar 18 ditë me vonesë nga afati i zbatimit të kontratës dhe për pasojë është nxjerr Urdhër i Brendshëm për likuidimin e dëmit për vonesën. Dëmi është llogaritur në masën 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbritur nga çmimi total i kontratës. Vlera e dëmit është llogaritur 268,704 lekë.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikim Raportimit më datë 05.10.2023 ka bërë përlllogaritjen e fondit limit me kërkesën e përgjegjësit të sektorit të TI për blerje materiale kompjuterike në vlerën 3,477,567 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1021 Prot., datë 06.10.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 143, datë 06.10.2023 nga Administratori i UKSH. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Blerje materiale kompjuterike” me fond limit 3,477,567 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e

shoqërisë. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga F.T, A.T dhe K.A.

- Me shkresën nr. 1022 Prot., datë 06.10.2023 është miratuar Urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr. 144, datë 06.10.2023 i përbërë nga L.P, kryetar Komisioni S.Sh dhe B.B.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 27.10.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën dy oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “R.A” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “S.C” me vlerë 3,449,600 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

- Me shkresën nr. 1373, datë 03.11.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “R.A” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1429 Prot., datë 10.11.2023 Administratori ka nxjerr një Urdhër të brendshëm mbi pezullimin e procedurës së prokurimit pas ankesës së OE “S.C” drejtuar Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

OE “S.C” ka bërë ankesë për të kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me pretendimin se OE “R.A” nuk ka objekt të aktivitetit të tij disa nga zërat e prokurimit si dhe nuk ka kapacitet teknik dhe as eksperiencë në ofrimin e produkteve apo shërbimeve të ngjashme.

Komisioni i Prokurimit Publik ka dërguar Vendimin nr. 1334/2023 me shkresën nr. 2771/12 Prot., datë 20.12.2023 dhe pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “S.C” ka vendosur të mos e pranojë ankesën mbi procedurën e prokurimit “e hapur, e thjeshtuar” me objekt “Blerje materiale kompjuterike” me fond limit 3,477,567 lekë pa TVSH dhe ka autorizuar AK Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit publik.

- Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka miratuar raportin përmbledhës nr. 2476 Prot., datë 28.12.2023 mbi tenderin me objekt “Blerje materiale kompjuterike” për të cilin u zhvillua tenderi më datë 23.10.2023 ku u paraqitën dy oferta nga OE “R.A” dhe “S.C” .

- Me shkresën nr. 2478 Prot., datë 28.12.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “R.A” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH.

- Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “R.A” kanë nënshkruar kontratën nr. 39 Prot., datë 08.01.2024 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kompjuterike” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH dhe 3,732,000 lekë me TVSH.

- Më datë 05.02.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të materialeve kompjuterike, ku komisioni i përbërë nga S.Sh, B.B dhe B.T kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Mallrat janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 158/2024, datë 15.01.2024 duke deklaruar përmbushjen e kushteve dhe specifikimeve të kontratës. Mallrat janë dorëzuar 18 ditë me vonesë nga afati i zbatimit të kontratës dhe për pasojë është miratuar një Urdhër i Brendshëm për likuidimin e dëmit për vonesën. Dëmi është llogaritur në masën 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbritur nga çmimi total i kontratës. Vlera e dëmit është llogaritur në masën 268,704 lekë.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ ***Procedura e prokurimit me objekt “Upgrade i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa” 2023***

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Upgrade i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa” 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 141, datë 06.10.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. F.T Z. A.T Z. K.A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. S.Sh Z. B.B Znj. B.K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,500,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 990,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 510,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 23.10.2023		
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP - ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 4 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 3 OE
12. Lidhja e kontratës: Nr. 420, dt. 09/02/2024	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,188,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 30 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 31.10.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 4 (katër) oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “E.S.S.shpk” me vlerë 1,200,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “iC shpk” me vlerë 1,300,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
3. Operatori Ekonomik “K. shpk” me vlerë 990,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
4. Bashkimi i Operatorëve “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” me vlerë 999,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.

Bashkimi i Operatorëve “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” dhe Operatori Ekonomik “K. shpk” paraqitën ankesa të cilat pas shqyrtimit nga KPP u kualifikuan nga KVO. Me shkresën nr. 2460 Prot., datë 27.12.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi zbatimin e Vendimit të KPP për rivlerësimin e ofertave nga KVO, të cilët kanë mbajtur një procesverbal më datë 28.12.2023 në të cilën janë kualifikuar të 3 operatorët ekonomikë.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Më datë 21.02.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve, nga Urdhri i Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ku Administratori ka caktuar komisionin të përbërë nga A.T, B.B dhe B.T. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 128, datë 21.02.2024.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikim Raportimit më datë 05.10.2023 ka bërë përlogaritjen e fondit limit për objektin blerje Upgrade i Programit të Faturimit në vlerën 1,500,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1019 Prot., datë 06.10.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 141, datë 06.10.2023 nga Administratori i SHUK. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Upgrade i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa” me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e shoqërisë. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga F.T, A.T dhe K.A.

- Me shkresën nr. 1020 Prot., datë 06.10.2023 është miratuar Urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr. 142, datë 06.10.2023 i përbërë nga S.Sh, kryetare Komisioni B.B dhe B.K.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 31.10.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 4 (katër) oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “E.S.S shpk” me vlerë 1,200,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “i.C shpk” me vlerë 1,300,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
3. Operatori Ekonomik “K. shpk” me vlerë 990,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
4. Bashkimi i Operatorëve “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” me vlerë 999,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.

- Me shkresën nr. 1417, datë 07.11.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “E.S.S shpk” me vlerë 1,200,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1641 Prot., datë 17.11.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi pezullimin e procedurës së prokurimit pas ankesës së OE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” drejtuar Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” ka bërë ankesë për të kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me pretendimin se duke u bazuar në Dokumentat Standarde të Tenderit, shtojcën 8, pika 2.3.3. Kapaciteti teknik kërkohet që OE të ketë autorizim në Programin kompjuterik “Al Billing”, sistemi i faturimit në përdorim dhe të jetë i regjistruar në ZSHDA mr nr. 57 RDA për kategorinë “Programe Kompjuterike” ose ekuivalente. Përsa më sipër BOE pretendon se e plotëson kriterin duke u bazuar në togfjalëshin “...ose ekuivalent”.

Gjithashtu, edhe OE “K. shpk” ka paraqitur ankesë mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me të njëjtin pretendim si BOE mbi kriterin e shtojcës 8 të DST.

Komisioni i Prokurimit Publik ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga Operatorët Ekonomik ankimes janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në DST. Përsa më sipër KPP ka vendosur të pranojë ankesat e BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” dhe OE “K. shpk” dhe ka kërkuar nga AK të shfuqizojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e operatorëve. Me shkresën nr. 2460 Prot., datë 27.12.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi zbatimin e Vendimit të KPP për rivlerësimin e ofertave nga KVO, të cilët kanë mbajtur një procesverbal më datë 28.12.2023 në të cilën janë kualifikuar të 3 operatorët ekonomikë.

- Me shkresën nr. 32 Prot., datë 05.01.2024 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “K. shpk” me vlerë 990,000 lekë pa TVSH.

- Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “K. shpk” kanë nënshkruar kontratën nr. 420 Prot., datë 09.02.2024 për procedurën e prokurimit me objekt “Upgrade i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe web serviseve për pagesa” me vlerë 990,000 lekë pa TVSH dhe 1,188,000 lekë me TVSH.

- Më datë 21.02.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve, nga Urdhri i Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ku Administratori ka caktuar komisionin të përbërë nga A.T, B.B dhe B.T. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili

ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 128, datë 21.02.2024.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 176, datë 30.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. F.T Znj. V.S Z. A.T	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. S.Sh Z. B.B Znj. B.K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,500,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,125,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 375,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 26.06.2023		
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP - ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
12. Lidhja e kontratës: Nr. 2366, dt. 18/12/2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,350,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 30 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Me shkresën nr. 1733 Prot., datë 20.11.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi zbatimin e Vendimit të KPP për rivlerësimin e ofertave nga KVO, të cilët kanë mbajtur një procesverbal më datë 20.11.2023 në të cilën është kualifikuar BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk”.

- Me shkresën nr. 1734 Prot., datë 20.11.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” me vlerë 1,125,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Më datë 15.01.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve, nga Komisioni i caktuar nga Administratori me Urdhrin e Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, të përbërë nga A.T, B.B dhe B.T. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje

me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 11/2024, datë 15.01.2024.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikim Raportimit më datë 29.03.2023 ka bërë përlllogaritjen e fondit limit për objektin blerje “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD” në vlerën 1,500,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 592 Prot., datë 30.03.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 176, datë 30.03.2023 nga Administratori i UKSH. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD” me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e shoqërisë. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga F.T, A.T dhe V.S.

- Me shkresën nr. 593 Prot., datë 30.03.2023 është miratuar Urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr. 177, datë 30.03.2023 i përbërë nga S.Sh, kryetare Komisioni B.B dhe B.K.

- Me shkresën nr. 1123 Prot., datë 13.06.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 309, datë 13.06.2023 “Për një ndryshim në urdhrin e prokurimit nr. 176, datë 30.03.2023”, në të cilin është bërë zëvendësimi i anëtarit të njësisë së prokurimit V.S me G.M.

- OE “P.A shpk” ka dërguar ankesë për AK dhe KPP në datë 07.04.2023, me arsyetimin se kanë identifikuar parregullsi në dokumentet e tenderit, konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, përkatësisht në shtojcën 8, kapitulli 2, pika 2.3.3 për të cilën është kërkuar heqja e kërkesës “... jo më herët se tre vjet”.

- Me shkresën nr. 684 Prot., datë 12.04.2023 është miratuar Urdhri i brendshëm mbi pezullimin e procedurave të prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës së OE “P.A shpk” sipas afateve ligjore.

- Komisioni i Prokurimit Publik ka dërguar vendimin nr. 475/2023 në të cilin ka shqyrtuar ankesat e paraqitura nga OE ankimes “P.A shpk” përkatësisht në datat 11.04.2023 dhe 14.04.2023, ku kjo e fundit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik. Përsa i përket ankesës së datës 11.04.2023 Komisioni i Prokurimit Publik e ka pranuar pretendimin e OE mbi kriterin kualifikues përsa i përket përcaktimit të afatit ligjor “... jo më herët se tre vjet”, pasi vendsja e këtij afati është me tejkalim të përcaktimeve ligjore në VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Përsa i përket ankesës së datës 14.04.2023 Komisioni i Prokurimit Publik nuk e ka marrë në shqyrtim pasi ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka respektuar afatet ligjore të dërgimit të argumenteve shtesë, duke shtuar se nuk ka përmbushur kushtet minimale për paraqitjen e argumenteve shtesë pasi kjo shkresë është dërguar vetëm pranë KPP.

Përsa më sipër KPP ka vendosur të pranojë ankesën e OE “P.A shpk” për procedurën e prokurimit me objekt “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD” me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH e parashikuar për tu zhvilluar në datë 13.04.2023 nga AK Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, ku i ka kërkuar këtij të fundit modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me konstatimet e KPP.

- Me shkresën nr. 1125 Prot., datë 13.06.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi zbatimin e Vendimit të KPP për ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit. Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit është bërë me shkresën nr. 1133 Prot., datë 13.06.2023 në të cilën është hequr togëfjalëshi “... jo më herët se tre vjet” dhe është vendosur afati i ri për paraqitjen e ofertave më datë 26.06.2023.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 04.07.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën dy (dy) oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “E.S.S shpk” me vlerë 1,170,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
2. Bashkimi i Operatorëve “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” me vlerë 1,125,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua.

Përsa më sipër asnjë nga ofertat nuk u kualifikua dhe KVO vlerësoi se tenderi duhet të anulohet për arsye se operatorët ekonomik nuk kanë plotësuar kriteret kualifikuese si dhe nuk kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

- OE “P.A shpk” ka dërguar ankesë për KPP në datë 01.09.2023 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor mbi anulimin e procedurës së prokurimit publik, si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a i ka dërguar KPP informacion mbi ankesën e OE “P.A shpk” ku ka arsyetuar se Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka mbyllur aktivitetin dhe ka transferuar të drejtat e tij, për rrjedhojë nuk ka pasur asnjë të punësuar përveç likuidatorëve të shoqërisë dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Gjithashtu, sqaron se ankesa e BOE nuk i është drejtuar SHRUK por UKSH, në këto kushte nuk e kanë marrë në shqyrtim ankesën.

KPP e ka hedhur poshtë arsyetimin e dhënë nga AK për arsye se ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi pasi bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 përcaktohen procedura dhe afate kohore të cilat duhen ndjekur për secilën prej procedurave deri në finalizimin e kthimit të shoqërive me përgjegjësi të përbashkët dhe situata nuk mund të jetë kurrësi përballë rrethanave të paparashikueshme ashtu si është shprehur AK duke mos shqyrtuar ankesën.

Përsa më sipër, KPP ka vendosur të pranojë ankesën e BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” për procedurën e prokurimit me objekt “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD” me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH. KPP ka vendosur anulimin e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit si dhe vendimin e KVO mbi skualifikimin e BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” duke e kualifikuar atë.

- Me shkresën nr. 1733 Prot., datë 20.11.2023 Administratori ka miratuar një Urdhër të brendshëm mbi zbatimin e Vendimit të KPP për rivlerësimin e ofertave nga KVO, të cilët kanë mbajtur një procesverbal më datë 20.11.2023 në të cilën është kualifikuar BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk”.

- Me shkresën nr. 1734 Prot., datë 20.11.2023 u miratua formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” me vlerë 1,125,000 lekë pa TVSH.

- Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a dhe BOE “P.A shpk” dhe “N.A.C shpk” kanë nënshkruar kontratën nr. 2366 Prot., datë 18.12.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Ristrukturim dhe migrim i DB të sistemit të faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD” me vlerë 1,125,000 lekë pa TVSH dhe 1,350,000 lekë me TVSH.

- Më datë 15.01.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve, nga Komisioni i caktuar nga Administratori me Urdhërin e Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, të përbërë nga A.T, B.B dhe B.T. Komisioni ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Shërbimet janë dorëzuar me faturën tatimore nr. 11/2024, datë 15.01.2024.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” 2023**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim interneti		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 154, datë 10.10.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. F.T Znj. I.M Z. K.A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. F.T Znj. I.M Z. K.A
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		

5. Fondi Limit (pa TVSH) 318,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 300,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 18,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 12.10.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) Skualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP – s'ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1292, dt. 23/10/2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 360,000 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Me shkresën nr. 1184 Prot., datë 13.010.2023 Komisioni i Blerjeve të Vogla ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën pesë oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 300,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “V.A” me vlerë 800,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;
3. Operatori Ekonomik “T.C.A” me vlerë 850,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;
4. Operatori Ekonomik “G.XH” me vlerë 899,900 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;
5. Operatori Ekonomik “O.A” me vlerë 1,000,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua.

Nuk ka të miratuar formularin e njoftimit të fituesit ku sipas kontratës së nënshkruar është Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 300,000 lekë pa TVSH dhe 360,000 lekë me TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1294 Prot., datë 23.10.2023 nga Administratori i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 202, datë 23.10.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës shërbim interneti”, të përbërë nga A.T kryetar, B.T dhe B.B anëtarë.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikim Raportimit më datë 09.10.2023 ka bërë përlllogaritjen e fondit limit me kërkesën e përgjegjësit të sektorit të TI për blerje shërbim interneti në vlerën 318,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1048 Prot., datë 10.10.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 154, datë 10.10.2023 nga Administratori i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a i cili ka si objekt “Shërbim interneti” me fond limit 318,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të

ardhurat e shoqërisë. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga F.T, I.M dhe K.A.

- Me shkresën nr. 1049 Prot., datë 10.10.2023 është publikuar ftesa për ofertë nga Komisioni i Blerjeve të Vogla. Po nga ky grup me shkresën nr. 1050 Prot., datë 10.10.2023 është mbajtur procesverbal “Për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

- Me shkresën nr. 1184 Prot., datë 13.10.2023 Komisioni i Blerjeve të Vogla ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën pesë oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 300,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;
2. Operatori Ekonomik “V.A” me vlerë 800,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;
3. Operatori Ekonomik “T.C.A” me vlerë 850,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;
4. Operatori Ekonomik “G.XH” me vlerë 899,900 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;
5. Operatori Ekonomik “O.A” me vlerë 1,000,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua.

- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “I.B.C.T”, e cila sipas sistemit të APP është publikuar në datë 13.10.2023.

- Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “I.B.C.T” kanë nënshkruar kontratën nr. 1292 Prot., datë 23.10.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” me vlerë 300,000 lekë pa TVSH dhe 360,000 lekë me TVSH. Kontrata nuk është nënshkruar brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë e cila parashikohej të ishte brenda 24 orëve nga data e konfirmimit të fituesit. Në kontratë nuk janë parashikuar penalitete në rast moszbatimi të shërbimeve.

- Me shkresën nr. 1294 Prot., datë 23.10.2023 nga Administratori i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 202, datë 23.10.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës shërbim interneti”, të përbërë nga A.T kryetar, B.T dhe B.B anëtarë.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” 2023**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim interneti		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1005, datë 24.05.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. F.T Znj. A.T Znj. B.A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. F.T Znj. A.T Znj. B.A
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 759,833 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 745,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 14,833 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 29.05.2023		

11. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP – s'ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 1 OE
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1071, dt. 06/06/2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 894,000 lekë	14. Afati i kontratës në muaj: 12 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 30.05.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 3 (tre) oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 745,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;

2. Operatori Ekonomik “EN.C” me vlerë 850,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;

3. Operatori Ekonomik “T.C.A” me vlerë 999,990 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;

Nga të tre operatorët u kualifikua vetëm Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 745,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1074 Prot., datë 07.06.2023 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 294, datë 07.06.2023 “Për zbatimin e kontratës”, të përbërë nga A.T kryetar, S.Sh dhe B.B anëtarë.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Planifikimit më datë 23.05.2023 ka bërë përlllogaritjen e fondit limit për objektin shërbim interneti në vlerën 759,833 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1005 Prot., datë 24.05.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 280, datë 24.05.2023 nga Administratori i UKSH, për procedurën me objekt “Shërbim interneti”.

- Me shkresën nr. 1006 Prot., datë 24.05.2023 është publikuar ftesa për ofertë nga Komisioni i Blerjeve të Vogla me përbërje F.T kryetar, A.T dhe B.A anëtarë. Në po këtë datë ky grup ka mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Nga dokumentacionet rezultoi se, miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku citohet se “Autoriteti Kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka listuar 7 kushtet për kualifikim të operatorëve ekonomikë, ku ndër to në pikën 6 kërkohet: “Operatori Ekonomik, përveç adresës kryesore, duhet të ketë të paktën edhe dy adresa të tjera dytësore në qytetin Shkodër”. Ky kriter konsiderohet diskriminues për ofertuesit e tjerë të cilët mund ta ofrojnë shërbimin e kërkuar duke plotësuar kushtet e tjera të vendosura nga Autoriteti Kontraktor.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 30.05.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 3 (tre) oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.B.C.T” me vlerë 745,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u kualifikua;

2. Operatori Ekonomik “EN.C” me vlerë 850,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;

3. Operatori Ekonomik “T.C.A” me vlerë 999,990 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla u skualifikua;

- Formulari i njoftimit të fituesit nuk është pjesë e dosjes së prokurimit publik me fitues OE “I.B.C.T”, e cila sipas sistemit të APP është publikuar në datë 31.05.2023.

- Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Operatori Ekonomik “I.B.C.T” kanë nënshkruar kontratën nr. 1071 Prot., datë 06.06.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim interneti” me vlerë 745,000 lekë pa TVSH dhe 894,000 lekë me TVSH. Kontrata nuk është nënshkruar brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë e cila parashikohet të ishte brenda 3 ditëve nga data e konfirmimit të fituesit. Gjithashtu, në kontratë nuk janë parashikuar penalitete në rast moszbatimi të shërbimeve.

- Me shkresën nr. 1074 Prot., datë 07.06.2023 nga Administratori i UKSH sh.a është ngritur urdhri i brendshëm nr. 294, datë 07.06.2023 “Për zbatimin e kontratës”, të përbërë nga A.T kryetar, S.Sh dhe B.B anëtarë.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj

3.Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit

a. Auditimi i sistemeve mbi të dhënat Input / Output

Objektivi i auditimit të sistemeve dhe kontrolleve të aplikacioneve, për të dhënat Input / Output që UKSH administron, është vlerësimi mbi efektivitetin e ndërtimit, operimit të kontrolleve të brendshme dhe saktësinë e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara si rezultat i zhvillimit informatik, që shoqëria ka pasur gjatë viteve. Po ashtu dhe auditimin mbi menaxhimin e përdoruesve dhe të drejtat e tyre në sistemin informatik.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “Auditimi i sistemeve”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

-Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;

-U mor akses ” në sistemin e faturimit dhe Web-Gis ;

-Manualet e përdorimit të sistemeve;

-Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;

-Të dhënat për përdoruesit e sistemeve

-Vizita në terren;

-Indikatorë dhe statistika;

-Etj.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit, UKSH ka implementuar disa sisteme informatike, të cilat janë:

-Sistemi i faturimit. (Al-Billing)

- Sistemi Web-Gis
- Sistemi i fiskalizimit
- Financa 5

Al Billing është sistemi i cili administron të gjithë informacionin një Shoqërie Ujësjiellës Kanalizime. Nëpërmjet këtij sistemi mund të administrohet informacioni i abonentëve si dhe specifikave të tyre, administrohet procesi i faturimit, tarifimit, procesi i arkëtimit, procesi i kërkesë/ankesave, administrohet posta elektronike, dhe të tjera. Të gjithë përdoruesit e sistemit, duhet të identifikohen dhe më pas të punojnë me proceset e përcaktuara. Detajet e abonentit janë të ndara me kategori duke bërë kështu që informacioni të jetë i strukturuar.

Sistemi i leximit të matësve. Me anë të këtij sistemi bëhet e mundur mbledhja e leximeve për të gjithë matësit e abonentëve të UKSH. Sistemi përbëhet nga software qendror që është i instaluar në server në data center dhe nga aplikacioni mobile që instalohet në pajisjet mobile që përdorin lexuesit e UKSH.

UKSH nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKSH.

Krijimi, administrimi i përdoruesve të sistemit Billing, realizohet nga Përgjegjësi dhe specialistët e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Përzgjedhja e funksionaliteteve të çdo roli për punonjës të zgjidhet nga ndërfaqja e sistemit.

Ndërfaqja e Sistemit Billing për krijimin e një përdoruesi të ri

Informacioni i Përdoruesit			
Përdoruesi:	<input type="text"/>	Fjalëkalimi:	<input type="text"/>
Emri:	<input type="text"/>	Mbiemri:	<input type="text"/>
Emri i plotë:	<input type="text"/>	Njësia:	Të gjitha
Datëlindja:	<input type="text"/>	Mesazhi:	<input type="text"/>
Pozicion përdoruesi:	Administrator	Statusi:	Aktiv
ID ARKA / BANKA:	Pa specifikuar	ID Departamenti:	Pa specifikuar
Te drejtat:			
Admin. Përdoruesish:	<input type="checkbox"/>	Auditim SW:	<input type="checkbox"/>
Abonenti:	<input type="checkbox"/>	Faturim:	<input type="checkbox"/>
Arketim:	<input type="checkbox"/>	Arketim Online:	<input type="checkbox"/>
Konsultim:	<input type="checkbox"/>	Njesi:	<input type="checkbox"/>
Front office:	<input type="checkbox"/>	Raporte 1:	<input type="checkbox"/>
Raporte 2:	<input type="checkbox"/>	Ankesat:	<input type="checkbox"/>
Import / Export:	<input type="checkbox"/>	Printim Fature:	<input type="checkbox"/>

Nga auditimi u konstatua se UKSH Sh.A nuk disponon një rregullore të miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve në sistemet që disponon me qëllim përcaktimin etributeve si krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve, të drejtave.

Nga auditimi rezulton se Fjalëkalimi në sistemin Billing aktualisht nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij .kriteret e ndërhuara për fjalëkalimet e përdoruesve fundor nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. - Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

UKSH nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Faturimit Në Sistemin e faturimit përdoruesi me të drejta ‘Administrator’ ka akses në një ndërfaqe në të cilën mund të gjurmohet veprimet që janë kryer me një praktikë të caktuar por jo të gjithë veprimet që kryen nga përdoruesit e sistemit. Sistemi ruan në bazën e të dhënave gjurmët e auditimit (audit trail) në të cilat ruhet informacioni i plotë

për veprimet që janë kryer nga përdoruesit e sistemit, por UKSH nuk kryen analizime periodikë të gjurmëve të auditimit të veprimeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemit.

Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit të UKSH sh.a rezulton se ky sistem ka nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht situata e konstatuar rezulton të jetë si më poshtë vijon:

- Tabela në të cilën ruhet NID i abonentëve në 95% të abonentëve nuk është populluar. Në disa raste janë vendosur numra dhe fjalë jo në formatin e NID.
- Tabela në të cilën ruhet NIPT-i për entet Private dhe Shtetërore është e populluar në masën 30% të subjekteve Publike dhe Privat. , në disa raste në këtë tabelë janë kryer dhe shënime të ndryshme duke mos ndjekur një format fiks për fushën NIPT
- Në tabelën në të cilën ruhen numrat e matësve për kontratat aktive me mënyrë faturimi me matje në 7% të rasteve kjo fushë është ‘‘NULL’’ , në disa raste ka shënime të ndryshme si : (Nuk lexohet , s’ka, pa numër serial). UKSH Sh.a .nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operacionale në Sistemin e Faturimit për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKSH Sh. A .

Nga auditimi i eksporteve të të dhënave të sistemit të faturimit u konstatua se :

- Ka përdorues me më shumë se 1 llogari në sistemin e faturimit
- Emrat e përdoruesve nuk ruajnë të njëjtin format

Tek fusha ID (e abonentit) u konstatua se

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet.

Nga auditimi i databazës u konstatua se:

-Mungesa e Monitorimit:

Baza e të dhënave nuk monitorohet në mënyrë aktive për performancën, shkelje të sigurisë apo aktivitete të pazakonta. Problemet e performancës që nuk vërehen mund të çojnë në ndërprerje dhe të ndikojnë në besueshmërinë e sistemit të faturimit. Shkeljet e sigurisë mund të mbeten të pavërejtura, duke ekspozuar të dhënat sensitive të klientëve.

-Mungesa e Kontrollit të Aksesit:

Nuk ka rishikim të rregullt nga stafi IT për të siguruar që baza e të dhënave funksionon si duhet. Mungesa e mbikëqyrjes mund të çojë në gabime ose konfigurime të gabuara që mund të ndikojnë në integritetin dhe saktësinë e të dhënave të faturimit.

-Mungesa e Mirëmbajtjes së Rregullt:

Baza e të dhënave nuk i nënshtrohet detyrave të mirëmbajtjes rutinë si përditësimet dhe optimizmit.. Pa mirëmbajtje të rregullt, baza e të dhënave mund të përballet me degradim të performancës, korruptimit të të dhënave ose humbje të të dhënave.

Menaxhimi i aseteve nga UKSH Sh.a. nëpërmjet programit Web Gis

Verifikimi i përdorimit të Aplikacionit Web Gis me qëllim që të dhënat të regjistrohen, programi të popullohet në mënyrë që të gjitha asetet e Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh. A. të ruhen në një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale, për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin.

Për menaxhimin e aseteve në UKSH është implementuar Programi ‘‘Web-GIS, i cili është një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale ndërtuar mbi arkitekturën multirole dhe multuser.

Me përdorimin e Web Gis UKSH Sh. A. mund të përcaktojë vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të zarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin (vendin) e objektit.

Në këtë sistem regjistrohen:

1. Ankesat	11. Burim vetërrjedhje	21. Kanalizim i Hapur
2. Zonë faturimi	12. Pus	22. Pusetë-Kanalizime
3. Pus familjar	13. Stacion pompimi	23. Gradele
4. Lidhje uji	14. Depo Uji	24. Pikë derdhje
5. Klient	15. Impiant Pastrimi	25. Impiant trajtim
6. Bashkues	16. Nyje	26. Stacion pompimi-
7. Linjë	17. Zonë hidraulike	27. Ndërtese
8. Pusetë	18. Bashkues mbi linjë	28. Rrugë
9. Ujëmatës zonal	19. Kanalizim nën tokë	

Sistemi ka të realizuar një sërë rolesh të cilat kanë mundësi krijimi apo aksesit të informacionit në aplikacion. Rolet(Grupet) janë si më poshtë:

•Administratori :

Ka mundësinë e menaxhimit të log-eve të sistemit. Sistemi mundëson monitorimin e çdo veprimi të kryer mbi të, në formën e log-eve. Loge-t mund të aksesohen dhe prej tyre të nxirren monitorime të ndryshme, duke filtruar sipas përdoruesit, datës dhe veprimet mbi sistemin.

•Punonjës i Ujësjellësit (ujë_punonjës)

Punonjësi i Ujësjellësit ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetin e ujësjellësit. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose dakordësi të përdoruesit që ka hedhur të dhënat. Ky përdorues ka gjithashtu të drejtë të lexojë por jo të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga sektori i kanalizimeve.

•Vizitor i Ujësjellësit

Vizitori i Ujësjellësit ka të drejta leximi mbi të gjitha objektet e rrjetit të ujësjellësit. Ai në çdo rast mund të verifikojë, analizojë, filtrojë, eksportojë të dhëna që kanë lidhje vetëm me rrjetin e ujësjellësit.

•Punonjës i Kanalizimeve

Punonjësi i Kanalizimeve ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetin e kanalizimeve. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga përdorueset e rrjetit të ujësjellësit.

•Vizitor

Vizitor është një përdorues i sistemit i cili ka të drejtë të lexojë çdo informacion që hidhet si për rrjetin e ujësjellësit ashtu dhe atë të kanalizimeve. Ai nuk ka të drejtë hedhje apo ndryshimi të dhënash në asnjë nga objektet e sistemit.

Me përdorimin e Web Gis UKSH Sh. A. mund të përcaktojë vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të zarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin(vendin) e objektit.

Nga auditimi u konstatua se Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (WebGis) i implementuar në UKSH Sh.A. është populluar në një përqindje të ulët duke mos përfunduar

identifikimin, pasqyrimin e aseteve të gjithë pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKSH Sh.a.

b. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Verifikimi i mjedisit të sigurisë së informacionit, vlerësimi i politikave të sigurisë. Siguria fizike e infrastrukturës TIK dhe saktësia e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara.

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Rregullore mbi Parimet dhe Rregullat e Përgjithshme të Sigurisë së Informacionit
- Procedurat e Back up;
- Procedura e Menaxhimit të Aksesit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;

Auditi i Sigurisë së Informacionit është një proces i vlerësimit të sigurisë së informacionit në Institucion për të identifikuar dhe adresuar rreziqet dhe incidentet e mundshme. Ky proces ndihmon Institucionet të sigurojnë që të dhënat dhe informacioni të jenë të mbrojtur dhe të sigurtë, të përmbushin kërkesat e ligjeve dhe standardeve të sigurisë së informacionit, dhe të rrisin ndërgjegjësimin e punonjësve të Institucioneve rreth sigurisë së informacionit dhe rreziqeve të mundshme. Auditimi i sigurisë së informacionit identifikon sfidat dhe rreziqet e mundshme në nivelin e sigurisë së informacionit dhe ndihmon në zhvillimin e strategjive për t'i përballuar ato. Në të njëjtën kohë, ai identifikon politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit dhe vlerëson se a janë ato të përshtatshme dhe të ndjekura me përpikëri nga punonjësit e Institucionit.

Çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverave me qëllim parandalimin e humbjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike. Dukë qenë se dhoma e serverave është një pikë delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit. Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të UKSH-së vizitoi onsite pajisjet fizike të UKSH.

Ambienti fizik i dhomës së serverave

Foto nr1,nr2 dhe nr.3



1.Shërbimet e ofruara me anë të Teknologjisë së Informacionit në UKSH mbështeten në një infrastrukturë IT (rrjeti network) të amortizuar, shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës.

2.Ambientet e mbajtjes se serverëve të UKSH-së nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008). Dhoma e serverëve si vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverët dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është pika më e ndjeshme e sistemeve të teknologjisë së informacionit të një institucioni.

Nga auditimi i dhomave të serverëve konstatohet se ka karakteristika teknike ndërtimi si vijon: Ky ambient ndodhet brenda dhomës së specialistit IT në zyrat e Shërbimit të klientit dhe Kryerjes së pagesave, e ndarë nga zyra me një derë alumini dhe fasadë xhami.

Pajisjet aktive të UKSH si Server, switch-e mbahen në ambiente që nuk plotësojnë standardet e miratuara nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve”.

Nga auditimi i kushteve dhe karakteristikave teknike të ndërtimit të dhomës së serverit u konstatua se:

a.Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluara nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
b.Dhoma nuk përbëhet nga një dyshe me teknologjike në të cilën të jetë e parashikuar pesha e rack- eve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen në të dhe nuk ka pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve;

c.Dhoma e serverëve nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;

d.Dhoma e serverëve nuk përmban kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;

e.Dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet teknike lidhur me kapacitetin dhe cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;

f. Në dhomën e serverëve mungon sistemi i alarmit dhe hyrja në dhomë nuk është e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe sistem alarmi në rast thyerje të saj; në kundërshtim me pikën 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.

g. Nga auditimi i administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një procedurë të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje– dalje të personave të paautorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës.

h .Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (dosje, dollap, karrige) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.

- Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat

-
Auditimi mbi planin e vazhdueshmërisë së biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të marri masat e nevojshme për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave. Në kundërshtim me këtë VKM, UKSH, si institucion që posedon disa sisteme informacioni, që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e arkëtimit të ardhurave nga pagesat e faturave prej qytetarëve

Nga auditimi u konstatua se UKSH, nuk rezulton të ketë, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit. UKSH nuk disponon dokumentacione në lidhje me:

- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të serverit që suportojnë sistemin e Faturimit, Web-Gis. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

Procedura e backup

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.


Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e UKSH. Backup-i i serverit, në të cilën ndodhet databaza e sistemit të faturimit kryhet manualisht nga Stafi i IT në HDD të jashtëm.

Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e UKSH Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyretributeve individualisht dhe pa autorizim nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira.

Aksesimi i sistemit

Nga auditimi dhe mbikëqyrja e sistemit nga Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurve HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web

browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.



Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali. Gjithashtu një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjet, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, duke përfshirë jo vetëm fjalëkalimet-et por dhe të dhënat financiare të faturimit.

Active Directory dhe Email Server

Pa Active Directory, çdo kompjuter në rrjet ka bazën e të dhënave të veta të vogla të emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve. Microsoft e quan këtë lloj krijimi një GRUP PUNE domethënë çdo kompjuter vepron më vete dhe nuk ka kontroll qendror. Ky lloj konfigurimi krijon një sfidë kur kemi shumë kompjutera dhe një përdorues duhet të ketë qasje në njërin prej tyre ose kur ai ndryshon fjalëkalimin ose emrin e përdoruesit. Active Directory mban në një memorie të centralizuar, emrat, përdoruesit dhe fjalëkalimet. Çdo ndryshim në emrat e përdoruesit dhe fjalëkalimet regjistrohen nga Active Directory dhe të gjithë kompjuterët në rrjet kanë qasje në këtë informacion. Prandaj Active Directory:

- Është në thelb një bazë të dhënash;
- siguron kontroll të centralizuar;
- regjistron të gjitha ndryshimet e fjalëkalimeve;
- mund të shpërndahet në të gjithë botën;
- ruan burimet si Printerët dhe share folders
- shërbimet si Email mund të përdorin Active Directory

Administratorët e rrjetit e përdorin Active Directory për të ruajtur dhe organizuar objekte në një rrjet (të tilla si përdoruesit, kompjuterët, pajisjet, etj.) Në një strukturë të sigurt hierarkike të kontrollit që njihet si strukturë logjike

Nga administrimi i dokumentacionit mbi parametrat e pajisjeve Server u konstatua se UKSH për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet nuk ka ngritur Active Directory.

Ngritja e një Active Directory për UKSH do të thotë, krijim dhe logimin e përdoruesve të UKSH dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in”. Përdoruesit mund të logohen me adresën e emailit në pc, në email, në rrjet e etj me anë të domain controller-it duke patur një autentifikim të sigurt. Me anë të “single sign in” përdoruesit mund të logojnë: në PC; - në network (wifi me pajisjet, laptop, smartphone, tablet, etj); - në email; - në apps; - etj. Duke krijuar usera manualisht, konfigurimin e emaileve për çdo user në mënyrë manuale dhe ruajtjen e të dhënave të përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qendëruar rrezikon kompromentimin e sigurisë së infrastrukturës network në UKSH

-Nga auditimi u konstatua se UKSH nuk disponon një Active Directory dhe një server për menaxhimin e emaileve të Insitucionit. Punonjësit përdorin emaile personale për komunikimet elektronike.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk disponon një strategji institucionale, si dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie institucionale ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë së institucionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nisur nga objektivat e UKSH dhe shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga sektori i IT për administrimin e sistemeve informatike, Sektori i IT i cili është në varësi të Drejtorisë Administrativo Ligjore e ka të pamundur të përgjigjet në kohë për problematikat e IT nisur nga shpërndarja fizike e pajisjeve, duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e shoqërisë, si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkte nga menaxhimi i lartë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit që ofron dhe të dhënave që institucioni disponon dhe përpunon, të analizojë mundësinë e ndryshimit të strukturës ekzistuese TI me qëllim rritjen e rolit të saj.

Menjëherë

3. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk ka propozime konkrete nga UKSH për zhvillimin e trajnimeve si dhe nuk është i dokumentuar procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim, duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime të punonjësve të Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen dhe tek punonjësit e tjerë, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

Në vijimësi

4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKSH nuk ka marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, si një dokument mbi të cilin kjo shoqëri bazohet për të kryer funksionet e saj. Me ndryshimet e ndodhura në strukturën e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ku sektori i IT nuk është më në varësi të Drejtorisë Tregtare por ka kaluar në varësi Drejtorisë Administrativo-Ligjore si dhe ristrukturimin e saj kjo rregullore nuk ka ndryshuar. Gjithashtu, në rregullore nuk janë pasqyruar përshkrimet e plota të detyrave duke mos përfshirë detyrat për specialistët përkatës të këtij sektori.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për përditësimin dhe implementimin e rregullores së brendshme si një dokument mbi të cilin kjo shoqëri bazohet për

të kryer funksionet e saj, duke përfshirë dhe përshkrimet e punës dhe duke i përshtatur ato me detyrat funksionale që punonjësit ushtrojnë.

Menjëherë

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a nuk disponon regjistër risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezulton të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Menaxhimi i riskut TI është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në UKSH. Institucioni duhet të kishte hartuar një regjistër rrisiku ku të ishin të përfshira edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në asnjë prej 10 dosjeve të prokurimit publik të marra në shqyrtim për tu audituar nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të hartojë një raport përmbledhës sipas formularit tip, për çdo procedurë që do të zhvillojë në të ardhmen në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit shërbim interneti për vitin 2023 me vlerë 745,000 lekë pa TVSH, kontrata ndërmjet palëve nuk është nënshkruar brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë e cila parashikohej të ishte brenda 3 ditëve nga data e konfirmimit të fituesit.

- Për procedurat e prokurimit në vijimësi:

- a. Shërbim i Mirëmbajtjes së Sistemit të Faturimit AL-Billing;
- b. Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike;
- c. Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS, për vitin 2022;
- d. Shërbim interneti 2022;
- e. Shërbim interneti 2023.

Miratimi i shkresës për specifikimet teknike është bërë pas publikimit të ftesës për ofertë në kundërshtim me nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në VKM nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për zbatimin e afateve dhe ndjekjen e rendit kronologjik të dokumentacionit sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillojë në vijimësi.

Në vijimësi

8. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për procedurën e prokurimit “*Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit të faturimit Al-Billing*”, Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar pranë UKSH asnjë raport mujor mirëmbajtje siç është përcaktuar në detyrat që duhen përmbushur në zbatim të kontratës. Mungesa e raporteve mujore përbën shkelje të kushteve kontraktuale dhe vështirëson ndjekjen dhe vlerësimin e saktë të këtij shërbimi, çfarë vështirëson mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve dhe zbatimit të kontratës duke krijuar mundësi për keqmenaxhim financiar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Ujësajllës Kanalizime Shkodër sh.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të vendosë dhe aplikojë mekanizma të kontrollit të brendshëm për respektimin e kritereve në kontratat e shërbimit të mirëmbajtjes me qëllim mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve dhe zbatimit të kontratës.

Menjëherë

9. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Për procedurat e prokurimit: “*Mirëmbajtje e sistemit të faturimit Al-Billing*” 2022, “*Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS*” 2022 dhe “*Shërbim interneti 2022*”, procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk janë pjesë e dosjeve të prokurimit në zbatim të Urdhrave të Brendshëm të Administratorit të shoqërisë.

- Për procedurat e prokurimit: “*Riparim dhe Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike*”, “*Shërbim mirëmbajtje të sistemit GIS*”, “*Shërbim interneti 2022*” dhe “*Shërbim interneti 2023*” formularët e njoftimit të fituesit nuk janë pjesë e dosjeve të prokurimit në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”. Pjesë e dosjeve është vetëm një shkresë e gjeneruar nga sistemi i APP-së mbi njoftimin e fituesit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Ujësajllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa që procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe formularët e njoftimit të fituesit të jenë pjesë e plotë e dosjeve të prokurimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet e brendshme. Gjithashtu, të trajnohen punonjësit që marrin pjesë në procedurat e prokurimit për të siguruar njohuri të plota mbi kërkesat ligjore dhe proceduriale.

Në vijimësi

10. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në dosjet e prokurimit publik të marra nën shqyrtim nga grupi i auditimit pjesa më e madhe e shkresave zyrtare nuk janë protokolluar, numerizuar dhe inventarizuar në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*” dhe “*Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”. Mungesa e protokollimit dhe numerizimit nuk lë gjurmë mbi vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tenderit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Ujësajllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për zbatimin në mënyrë rigorozë të procesit të protokollimit, numerizimit dhe inventarizimit të të gjitha shkresave zyrtare të prokurimit, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për përmirësimin e situatës të trajnojë punonjësit përgjegjës për arkivimin dhe menaxhimin e dokumenteve në lidhje me normat ligjore dhe metodologjitë e protokollimit të dokumentacionit zyrtar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje materiale kompjuterike*” me vlerë 3,110,000 lekë pa TVSH, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor (AK) dhe Operatorit Ekonomik (OE) “*R.A shpk*” me kontratën nr. 39 Prot., datë 08.01.2024, mallrat janë dorëzuar me një vonesë prej 18 ditësh nga afati i përcaktuar

në kontratë. Për shkak të kësaj vonese është miratuar një Urdhër i Brendshëm për për mbajtjen e një penalteti në vlerën 268,704 lekë. Megjithatë, auditimi konstatoi se sektori i financës nuk ka kryer likuidimin e kontratës, edhe pse OE ka dorëzuar faturën nr. 158/2024, datë 15.01.2024. Për më tepër, nuk janë ndërmarrë masa për të mbajtur penaltetin për vonesën e mallrave, ndonëse kanë kaluar afërsisht 6 muaj që nga përlogaritja e dëmit. Kjo vonesë përbën një mosrespektim të detyrimeve financiare dhe ligjore, duke rritur rrezikun e humbjes së fondeve të parashikuara për kompensim të dëmit dhe duke ndikuar negativisht në menaxhimin e fondeve publike.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A të marrë masa për respektimin e kushteve të kontratës për likuidimin e faturave, duke mbajtur penaltetin e përlogaritur në përputhje me nenin 23 të kontratës, në vlerën 268,704 lekë për vonesën e dorëzimit të mallrave.

Menjëherë

12.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKSH SH.A nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në sistem.

- Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” i vënë ne dispozicion nga OE jo vetëm që nuk është përditësuar, por në përmbajtje të tij ka informacione e përshkrime që nuk i përkasin UKSH.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKSH. Sh.A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të sistemit të faturimit, ku të përfshihen operacionet TI, afatet, kontrollet e brendshme dhe miratimi i ndryshimeve. Manuali i përdorimit të sistemit duhet të përditësohet pas ndryshimeve periodike në sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Fjalëkalimi në sistemin Billing aktualisht nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij kriteret e ndërtuara për fjalëkalimet e përdoruesve fundorë nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë.

-Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet.

-Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: UKSH Sh.A, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemin “Billing” ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu, të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit mbi funksionalitetet e sistemit informatik “Billing”.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKSH nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Faturimit. Në Sistemin e faturimit përdoruesi me të drejta “Administrator” ka akses në një ndërfaqe në të cilën mund të gjurmohet veprimet që janë kryer me një praktikë të caktuar por jo të gjithë veprimet që kryen nga përdoruesit e sistemit. Sistemi ruan në bazën e të dhënave gjurmët e auditimit (audit trail) në të cilat ruhet informacioni i plotë për veprimet që janë kryer nga përdoruesit e sistemit, por UKSH nuk kryen analizime periodikë të gjurmëve të auditimit të veprimeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetës Kanalizime Shkodër Sh.A, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT të UKSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit të UKSH sh.a rezulton se ky sistem ka nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht situata e konstatuar rezulton të jetë si më poshtë vijon:

Tabela në të cilën ruhet NID i abonentëve në 95% të abonentëve nuk është populluar. Në disa raste janë vendosur numra dhe fjalë jo në formatin e NID.

Tabela në të cilën ruhet NIPT-i për entet Private dhe Shtetërore është e populluar në masën 30% të subjekteve Publikë dhe Privat, në disa raste në këtë tabelë janë kryer dhe shënime të ndryshme duke mos ndjekur një format fiks për fushën NIPT

Në tabelën në të cilën ruhen numrat e matësve për kontratat aktive me mënyrë faturimi me matje në 7% të rasteve kjo fushë është “NULL” në disa raste ka shënime të ndryshme si: (Nuk lexohet, s’ka, pa numër serial).

Nga auditimi i të dhënave për user-at e sistemit të faturimit u konstatua se :

- Ka përdorues me më shumë se 1 llogari në sistemin e faturimit
- Emrat e përdoruesve nuk ruajnë të njëjtin format.

Këto mangësi sjellin risk për-garantimin e plotësisë dhe integritetit të të dhënave të sistemeve IT dhe janë në kundërshtim me Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; Neni 27, Ligji Nr. 9887, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të UKSH Sh.A duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikave të konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i sigurisë së databazës u konstatua se:

- Baza e të dhënave nuk monitorohet në mënyrë aktive për performancën, shkelje të sigurisë apo aktivitete të pazakonta. Problemet e performancës që nuk vërehen mund të çojnë në ndërprerje dhe të ndikojnë në besueshmërinë e sistemit të faturimit. Shkeljet e sigurisë mund të mbeten të pavërejtura, duke ekspozuar të dhënat sensitive të klientëve.

- Nuk ka rishikim të rregullt nga stafi IT për të siguruar që baza e të dhënave funksionon si duhet. Mungesa e mbikëqyrjes mbart riskun për gabime ose konfigurime të gabuara që ndikojnë në integritetin dhe saktësinë e të dhënave të faturimit.
- Baza e të dhënave nuk i nënshtrohet detyrave të mirëmbajtjes rutinë si përditësimet dhe optimizimet. Pa mirëmbajtje të rregullt, baza e të dhënave mund të përballet me degradim të performancës, korruptimit të të dhënave ose humbje të të dhënave.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: UKSH Sh.A për rritjen e sigurisë së bazës së të dhënave të sistemit të faturimit të krijoj një plan mirëmbajtjeje që përfshin përditësimet e softuerit, optimizimin e performancës dhe kryerjen e backup-it të rregullt të të dhënave në rast të humbjes ose korruptimit të pajisjeve fizike.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (WebGis) i implementuar në UKSH Sh.A. është populluar në një përqindje të ulët duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të gjithë pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKSH Sh.a.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: UKSH Sh.A. të identifikojë dhe pasqyrojë të gjitha asetet e rrjetit të ujit, duke përfshirë mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave për të gjitha pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe shpërndarjes së ujit. Krijimi i procedurave standarde për mbledhjen, verifikimin dhe regjistrimin e të dhënave është kyç për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në WebGis.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dhomave të serverëve konstatohet se ka karakteristika teknike ndërtimi si vijon:

Ky ambient ndodhet brenda dhomës së specialistit IT në zyrat e Shërbimit të klientit dhe kryerjes së pagesave, e ndarë me një derë alumini dhe fasadë xhami.

Pajisjet aktive të UKSH si Server, switch-e mbahen në ambiente që nuk plotësojnë standardet e miratuara nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve”.

Nga auditimi i kushteve dhe karakteristikave teknike të ndërtimit të dhomës së serverit u konstatua se:

-Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);

- Dhoma nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike në të cilën të jetë e parashikuar pesha e rack- eve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen në të dhe nuk ka pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve;

-Dhoma e serverëve nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;

-Dhoma e serverëve nuk përmban kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;

-Dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet teknike lidhur me kapacitetin dhe cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;

-Në dhomën e serverëve mungon sistemi i alarmit dhe hyrja në dhomë nuk është e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe sistem alarmi në rast thyerje të saj; në kundërshtim me pikën 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.

-Nga auditimi i administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një procedurë të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje– dalje të personave të paautorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës.

-Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (dosje, dollap, karrige) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: UKSH Sh.A të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKSH SH.A, nuk rezulton të ketë dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit. UKSH nuk disponon dokumentacione në lidhje me planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të serverit që suportojnë sistemin e Faturimit, Web-Gis. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

-Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e UKSH Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to. Administrimi i këtyretributeve individualisht dhe pa autorizim nuk jep siguri të arsyeshme për kryerjen e tyre sipas praktikave më të mira.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në UKSH Sh.A në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat. Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të Ujësjesit, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cenimin e të dhënave të sistemeve.

Menjëherë

20.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi dhe mbikëqyrja e sitemit nga Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurve HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali. Gjithashtu një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjet, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, duke përfshirë jo vetëm fjalëkalimet-et por dhe të dhënat financiare të faturimit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1Rekomandimi: Sektori i Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për vendosjen e certifikatës së sigurisë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) në mënyrë që të krijohet një kanal i sigurt për aksesimin e sistemit të faturim-arkëtimit “Billing”.

Menjëherë

21.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKSH SH.A nuk mbështet në standarde ndërkombëtare të ISO/ISEC 27001 për përdorimin Active Directory dhe mail server për menaxhimin e emaileve të Institucionit. Punonjësit përdorin emaile personale për komunikimet elektronike.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: UKSH Sh.A të marrë masa për implementimin e: Active Directory për një menaxhimin efektiv aksesit të punonjësve në burimet e institucionit. Ky sistem do të ofrojë një qendër të përbashkët për administrimin e llogarive të përdoruesve, duke përmirësuar ndjeshëm sigurinë dhe efikasitetin e menaxhimit të aksesit.

- UKSH Sh.A të marrë masa për implementimin e një serveri të menaxhimit të emaileve do të sigurojë që të gjitha komunikimet elektronike të jenë të mbrojtura dhe të sigurta. Kjo do të ndihmojë në mbrojtjen e të dhënave sensitive dhe në përmirësimin e besueshmërisë së komunikimit brenda institucionit. Është thelbësore që të gjithë punonjësit të përdorin email-e zyrtare për komunikimet e tyre, duke shmangur përdorimin e emaileve personale për çështje zyrtare.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT